

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 632 Prot.

Tiranë, më 10.052017

**VENDIM Nr. 71, datë 26.04.2017**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7, datë 26.04.2017, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, "Foinike – Butrint"*, me drejtues Prof. Shpresa Gjongecaj dhe Prof. Sandro de Maria, miratuar me vendim të Këshillit Shkencor të Institutit të Arkeologjisë paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, "Foinike – Butrint"*, me drejtues Prof. Shpresa Gjongecaj dhe Prof. Sandro de Maria, miratuar me vendim të Këshillit Shkencor të Institutit të Arkeologjisë paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Sondazhe dhe kërkime në sektorin e agorasë helenistike dhe bazilikës paleokristiane (A23); Gërmime në pjesën lindore të kodrës (A5); Kërkimet në banjën romake (A20); Vazhdimi i gërmimeve në "Banesa me suva" (C4)
  - Restaurimi i strukturave të gërmuara dhe valorizimi i sitit; Survejimi i territorit; Shkolla e arkeologjisë.
  - Përdorimi i një skrepi, me qëllim pastrimin e dherave sipërfaqësore dhe spostimin e dherave nga gërmimet në kuadër të projektit.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë do të jetë periudha kohore e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2017.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Rudina Zoto", written over a large, light blue circular scribble.